



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 62, Datë 11.04.2022**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “KESH” SH.A., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK I DIGËS QYRSAQ, HEC VAU I DEJËS, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5.143 MWp**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma” a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes me nr. 434/5 prot., datë 05.04.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik i Digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp”.

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 3, datë 13.01.2022, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik i Digës Qyrmaq, HEC Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5143 kWp, për një afat 25 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70 prot., datë 14.01.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 24.02.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- ERE me shkresat nr. nr. 111 prot., datë 20.01.2022 dhe nr. 111/2 prot., datë 01.03.2022, i është drejtuar shoqërisë për plotësimin e dokumentacionit të munguar. Ndërsa shoqëria KESH sh.a. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 111/1, datë 17.02.2022 dhe nr. 111/3, datë 25.03.2022, ka përcjellë sqarime dhe dokumenta plotësues për sa kërkuar nga ERE.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “KESH” sh.a., rezulton se janë plotësuar kërkesat e “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gërma “c”, “d”. Plotësuar.
  - Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.4.1; 4.4.2; 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.4.4, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.
  - Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.4.5, gërmat “a”, “b”. Plotësuar.
- **Në këtë aplikim mbetet ende pa plotësuar si vijon:**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:
    - gërma “d” (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).  
**Duke qenë se konstatohet mungesë e vërtetimit të gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e KESH sh.a., dhe kjo e fundit në e-mailin e saj drejtuar ERE-s (datë 01.04.2022), ka bërë me dije se është në proces të marjes së këtyre vërtetimeve, vlerësohet vendosja si kusht në dispozitiv të vendimit për dokumentimin në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:
    - gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore).  
**Duke qenë se shoqëria KESH sh.a ka detyrime (gjoja) në Tatimin mbi Fitimin dhe Dënime pa Tatim dhe në e-mailin e saj drejtuar ERE-s (datë 01.04.2022), ka bërë me dije se ka kundërshtuar në gjykatë gjobat e sipërcituara dhe është në proces gjyqësor, vlerësohet vendosja si kusht në dispozitiv të vendimit, që në përfundim të procesit gjyqësor shoqëria KESH sh.a., të bëjë me dije ERE-n për vendimin e gjykatës.**
  - gërma “b” (bilanci financiar të tre viteve të fundit / ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqërite me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).  
**Duke qenë se shoqëria KESH sh.a., ka informuar se pasqyrat financiare për vitin 2020 janë duke u hartuar për shkak të vonësive të natyrës teknike dhe pritjet të përfundojnë në fund të muajit maj 2022, vlerësohet vendosja si kusht në dispozitiv të vendimit, paraqitja e këtyre pasqyrave financiare jo më vonë se data 30.06.2022, në zbatim të nenit 46, të ligjit nr. 43/2015.**
  - Ndërtimi i projektit të centralit gjenerues të energjisë elektrike nga dielli (fotovoltaike) është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 08.07.2021, “*Për miratimin e*

*ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe të veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në Digën e Qyrfaqit, HEC Vau i Dejes, Qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a)”.*

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, VNM Paraprake, lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit, më datë 24.03.2021. VNM-ja Paraprake është lëshuar për ndërtimin e Centralit Fotovoltaike me kapacitetin e instaluar prej 5.143 MWp **Sa më sipër, nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria konstatojmë se Leja e ndërtimit është miratuar nga KKT-ja më datë 21.10.2021 me vendimin nr. 2. Pra, miratimi është dhënë brenda afatit dy vjeçar që parashikon VNM-ja Paraprake dhe në kushtet kur ndërtimi i centralit ka përfunduar (sikurse deklaron shoqëria punimet kanë filluar në datën 29.10.2021 dhe kanë përfunduar në datën 12.02.2022), kjo leje konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim.**
- ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qënë se nga Studimi i Fizibilitetit të centralit fotovoltaike të Digës së Qyrfaqit rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 – vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike i Digës Qyrfaq, HEC Vau i Dejes, me kapacitet të instaluar 5143 kWp, për një afat 25 vjeçar.
2. Shoqëria KESH sh.a., duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
3. Shoqëria KESH sh.a., duhet të bëjë me dije në ERE mbi vendimin e gjykatës në lidhje me ankimin e detyrimeve (gjoha) në Tatimin mbi Fitimin dhe Dënime pa Tatim, për të cilat është në proces gjyqësor, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit të gjykatës
4. Shoqëria KESH sh.a., duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020 të audituara, jo më vonë se data 30.06.2022.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.
6. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**